



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
REKTORI

Nr. 1721/2 Prot.

Tiranë, më 15.09.2026

V E N D I M

Nr. 240 Datë 15.09 2026

PËR

**SHPALLJEN E KONKURSIT PËR PRANIMIN E 1 (NJË) PUNONJËSI, PERSONEL
AKADEMIK "LEKTOR" LËVIZJE PARALELE PRANË FAKULTETIT TË
SHKENCAVE TË LËVIZJES, NË UNIVERSITETIN E SPORTEVE TË TIRANËS**

Mbështetur në Ligjin nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë", Kreu VI, PERSONELI I INSTITUCIONEVE TË ARSIMIT TË LARTË, në VKM nr. 123, datë 17.02.2010 "Për krijimin e Universitetit të Sporteve të Tiranës", në Rregulloren "Për rekrutimin e personelit akademik dhe ndihmës akademik të Universitetit të Sporteve të Tiranës", gërma B, "Lëvizjet paralele për stafin akademik", pika 2, në Strukturën Organizative dhe Analitike të UST-së, si dhe në shkresën e Dekanit të FSHL me nr. 1721/1, datë 14.09.2026 "Përcjellje kërkesë për lëvizje paralele për staf akademik në Departamentin e Sporteve Individuale për lëndën "Gjymnastikë" për vitin akademik 2026-2027 në FSHL", Rektori,

V E N D O S I :

Të shpallë konkurimin për 1 (një) vend pune për personel akademik me kohë të plotë "Lektor", "Lëvizje paralele", pranë Departamentit të Sporteve Individuale, Fakulteti i Shkencave të Lëvizjes, në Universitetin e Sporteve të Tiranës.

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme për pozicionin e punës si "Lektor" me kohë të plotë në Departamentin e Sporteve Individuale, Lënda; "Gjymnastikë", si më poshtë;

I. KRITERE TË PËRGJITHSHME

I	KRITERE ELIMINUESE
1	Të ketë përfunduar studimet në fushën e kërkuar në përputhje me pozicionin e punës
2	Të mbajë të paktën gradën shkencore "Doktor". (Grada shkencore e mbrojtur në institucione të huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuar jashtë vendit, duhet të jetë njohur dhe njësuar paraprakisht nga Ministria përgjegjëse për Arsimin në Shqipëri).
3	Të zotërojë me dëshmi së paku një nga 5 gjuhët e Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht; minimumi niveli B2) të fitura konform legjislacionit në fuqi.
4	Të ketë zotësi të plotë për të vepruar.
5	Të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë nga gjykata;
6	Të mos ketë prishur imazhin e UST-së;
Shënim: Në rast mosplotësimi të kriterëve më sipër dosja e aplikantit nuk duhet të pranohet.	

II. KRITERE SPECIFIKE

1. Kandidatët të kenë diplomë në fushën përkatëse.
2. Të ketë kryer aktivitete shkencore si: referime, botime brenda dhe jashtë vendit që kanë lidhje me fushën e studimit të kërkuar.
3. Vlerësohen kualifikime të ndryshme në nivel pasuniversitar që i përkasin fushës së studimit.

III. KRITERE PREFERENCIALE:

1. Preferohen kandidatët që kanë përvojë akademike në fushën përkatëse.

IV. Kandidatët që do të aplikojnë për këto vënde pune duhet të dorëzojnë këto dokumenta:

- a) Mbushja e aplikimit (formulari tip) dhe firmosja e tij në çdo faqe, të cilën e shkarkoni nga Eeb-siti i UST-së.
- b) Shprehje e interesit nga ana e kandidatit me shkrim për plotësimin e vendit vakant duke shprehur në të edhe vizionin e tij për këtë pozicion.
- c) Biografi e punës mundësisht me eksperiencat që lidhen me vendin e punës për të cilin aplikon kandidati.
- d) Kopje e noterizuar e diplomës/ve dhe listës/ve të notave. (Diploma e lëshuar nga institucione të huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuar jashtë vendit, duhet të jetë njohur dhe njësuar paraprakisht nga Ministria përgjegjëse për Arsimin në Shqipëri).
- e) Dokumentacionin shoqërues përkatës të nevojshëm original ose të noterizuar, sipas plotësimit të kriterëve të shpallura.
- f) Vërtetim i gjendjes gjyqësore (dëshmi penaliteti) ose formulari i vetëdeklarimit.
- g) Letra rekomandimi nga profesorë të fushës.
- h) Fotokopje të dëshmive të kualifikimeve të ndryshme, të noterizuara.
- i) Listë të punimeve shkencore të publikuara në revista ndërkombëtare profesionale/shkencore dhe/ose punime të tjera, pjesëmarrje në referime shkencore, në konferenca etj; (mundësisht linku i artikullit ose conferences. ISBN ose ISSN të artikujve ose botimeve).

V. Mënyra e dorëzimit të dokumentacionit

- Dokumentacioni duhet të dorëzohet pranë zyrës së Arkiv/Protokollit të UST-së brenda datës së përcaktuar në shpalljen për vlerësim të kandidaturave.

VI. Afati i dorëzimit të dokumentacionit nga kandidatët

- Afati i dorëzimit të dokumentacionit nga kandidatët është 5 (pesë) ditë pune nga data e publikimit të njoftimit në faqen e UST-së.
- Në zarf duhet të shënohet adresa e saktë e aplikimit; Universiteti i Sporteve të Tiranës, Fakulteti i Shkencave të Lëvizjes dhe departamenti, specialiteti ku aplikon, emri mbiemri.
- Mosparaqitja e saktë dhe e qartë e këtyre të dhënave përbën shkak për mospranimin e paketës së konkurentit.

VII. Ngarkohet Drejtoria e Zhvillimit të Programeve dhe Digjitalizimit të Shërbimeve Akademiko-Shkencore për publikimin e këtij konkursi në website të UST-së, www.ust.edu.al.

VIII. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

REKTORI

Prof. Dr. Agron KASARI

